



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DEVOLL
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ prot.

Bilisht, më _____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Blerje Automjete"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Automjete – 34100000-8,

VLERA E FONDIT LIMIT: 3,050,000 (tre milion e pesëdhjetë mijë) leke pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar , nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Devoll** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar .

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 "Kriteret detyruese për skualifikim" Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të Nenit 26 "Formulari përmbledhës i

vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: i ndryshuar

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit të shtojcës (Shtojca 9).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022,2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar , neni 55, pika 4, “Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar , e cila parashikon se Autoriteti kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë

maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për pervojën e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të kontratës.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.i ndryshuar Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 55, pika 4, germa b) në vlerën 20% të fondit limit.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të shërbimit të kërkuar objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar kontrata të ngjashme, të jete afër limitit maksimal të lejuar dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **certifikatën ose librezën e mjetit, foto të mjeteve** të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara dhe me përshkrimin e karakteristikave teknike të mjetit që ofron.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 6 germa b e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dorezojnë fotografite Kjo kerkese eshte ne perputhje me objektin e prokurimit dhe zbatimin me sukses te saj, me qellim marrjen e mjetit sipas specifikimeve te kerkuara.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqese një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit te mjetit me mjetet dhe shpenzimet e tij prane autoritetit kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër te kryejne sherbimin e transportit ne adresen e percaktuar te Autoritetit Kontraktor.. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor per zbatimin me sukses te kontrates objekt prokurimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me LPP-në dhe në to përcaktohen qartë karakteristika e mallit objekt prokurimi duke mos përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Specifikimet teknike në

rastin konkret nuk përbëjnë pengesë për konkurrencën e hapur dhe pjesënarrjen e OE të cilët tregëtojnë mjete.

Specifikimet teknike për mjetet janë vendosur me qëllim për të përshkruar sa më mirë mjetin e kërkuar nga AK për të shërbyer punës dhe qëllimit të tij.

Specifikimet teknike për mjetet janë ven

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikime teknike për Makinen e llojit Veturë janë si më poshtë vijon:

- 1-Viti i Prodimit 2011 deri 2014
- 2- Fuqia Motorike: 2500 deri 3000 (që mos përfshihet nga taksa e luksit mbi 3000 cc)
- 3-Numri i portave: 5
- 4-Lenda djegëse: Naftë
- 5- Preferohet të jetë 4x4 (për shkak të klimes dhe terrenit)
6. Preferohet të jetë full option
- 7- Preferohet që të mos ketë më shumë se 6 (gjashtë) muaj në territorin e Shqipërisë
- 8- Kilometrat preferohen të jenë jo më shumë se 100 ,000 km
- 9- Ngjyrat preferohen të jenë Gri, ose e Zeze
- 10- Të jetë në gjendje të mirë estetike brenda dhe jashtë
- 11- Gomat dhe disqet në gjendje të reja dhe gjendja teknike të jetë shume.

Afatet e lëvrimit:

1 (një) muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Njesia e Prokurimit:

12. Konsumi jo më shumë se 10 l/100 km

Specifikime teknike për Makinen e llojit Kamioncinë me Karoceri janë si më poshtë vijon:

- 1-Viti i Prodimit jo më i vjetër se 2010
- 2- Fuqia Motorike: deri 2500
- 3 -Karoceria të jetë 2.5 deri në 3 m e gjatë dhe me sponde të gjata dhe të jetë me vetshkarkim
- 4-Numri i portave: 4
- 5-Numri i vendeve: 5+1
- 6-Numri i gomave: 6 ,Gomat dhe disqet në gjendje të reja dhe gjendja teknike të jetë shume
- 7- Të jetë në gjendje të mirë estetike brenda dhe jashtë
- 8- Të jetë në gjendje shume të mirë teknike
- 9-Lenda djegëse: Naftë
- 10- Preferohet që të mos ketë më shumë se 6 (gjashtë) muaj në territorin e Shqipërisë
- 11- Kilometrat preferohen të jenë jo më shumë se 150 ,000 km
12. Konsumi jo më shumë se 10 /100 km

